

# R A P O R T

## HARTËZIMI I TRAJNIMEVE PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE NË SHQIPËRI

Raporti u hartua nga:

**Alda Dekovi**

Mars 2024

"Bashki të Forta" (BtF), projekt i inicuar dhe financuar nga Agjencia Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i zbatuar nga Helvetas.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



**HELVETAS**

*Hartimi i këtij raporti u mundësua nga projekti “Bashki te Forta”, një projekt i inicuar dhe financiar nga Agjencia Svicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), dhe zbatuar nga Helvetas, dhe pati kontribut të cmuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), Shkolla Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe shoqatat e NJVV-ve, SHAV dhe SHKQSH.*

*Dëshirojmë të vlerësojmë të gjithë aktorëve që morën pjesë në procesin e hartëzimit të trajnimeve, si dhe kontributin e ekipit të BtF-së, kryesisht Norbert Piljs, Valbona Karakaçi dhe Artan Rroji.*

*Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC.*

**© Bashki të Forta-Helvetas 2024**

## PËRMBAJTJA

1. Sfondi .....	4
2. Synimi dhe target i ushtrimit .....	6
3. Metodologjia.....	6
4. Procesi i konsultimit.....	8
5. Vështrim mbi aktorët e sistemit dhe ofrimin e trajnimeve për pushtetin vendor.....	9
6.1 Sfondi i përgjithshëm i të gjithë strukturës ofruese të trajnimeve për NJVV-të .....	11
6.2 Modulet, trajnimet e identifikuar sipas kategorive horizontale dhe sektoriale .....	12
6.3 Modulet dhe trajnimet e identifikuar sipas grupeve të synuara: të zgjedhur dhe administratë publike (nëpunës civil dhe Kod Pune) .....	15
6.4 Modulet dhe trajnimet e identifikuar sipas grupeve kryesorë të ofruesve të trajnimeve. ....	16
6.5 Modulet dhe trajnimet e planifikuara për vitin 2024 .....	17
6. Modulet e integritit evropian .....	18
7. Modulet e-learning .....	19
8. Kosot e trajnimit .....	19
9. Konstatime dhe rekomandime .....	19
Shtojca nr. 1 – Takimet konsultuese me aktorët e sistemit .....	25
Shtojca nr. 2 – Lista e të anketuarve kyc .....	26
Shtojca nr. 3 – Pyetësi tip .....	27
Shtojca nr. 4 - Modulet e trajnimeve të zhvilluara në periudhën 2019-202 .....	28
Shtojca nr. 5 – Ministria e Financave, trajnimet për NJVV-të, periudha 2019- 2023.....	41
Shtojca nr. 6 – Matrica e trajnimet për vitin 2024 .....	43
Shtojca nr. 7 – Modulet që administaron ASPA për trajnimet për NJVV-të.....	46

## 1. SFONDI

Bashki te Forta 2 është angazhuar për të mbështetur aktorët, kryesisht, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), Ministrinë e Financave, njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) dhe shoqatat e NJVV-ve, për të lehtësuar procesin e identifikimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të modaliteteve të ardhshme (përfshirë qëndrueshmërinë financiare) të sistemit për ndërtimin e kapaciteteve të NJQ-ve, përmes një procesi që përfshin shumë aktorë. Synimi është të mbështesë modalitetet e një sistemi shqiptar të ndërtimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore të bashkive (të zgjedhurit dhe stafi).

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor ka mbështetur iniciativën, ndërkohë me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 6, datë 12.01.2024 është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) për hartimin e propozimeve për themelimin e Akademisë së Trajnimit për Qeverisjen Vendore (Akademia). Në GNP janë përfshirë të gjithë aktorët e sistemit duke siguruar përfshirjen e të dhënave dhe mendimet e tyre. Miratimi i legjislacionit përkatës dhe alokimi nga Qeveria i buxhetit në vitin 2024, do të mundësojë që Brenda të njëjtit vit të themelohet kjo strukture të re, Akademia e Trajnimit për Qeverisjen Vendore për rritjen e kapaciteteve të NJVV-ve, që të fillojë veprimtarinë në vitin 2025. Gjatë vitit 2024, Bashki te Forta 2 do të mbështesë aktorët e sistemit të kryejnë Fazën e Tranzicionit për të përgatitur themelimin e Akademisë, duke punuar ngushtësisht me AMVV. Kjo e fundit, me Urdhër të Kryeministrit Nr. 6, datë 12.01.2024 ka vijuar koordinimin e procesit për të përfshirë të gjithë aktorët.

ASPA është institucioni shtetëror kombëtar i cili ka mandatin ligjor dhe rolin kyc në ofrimin e trajnimeve për NJVV-të në drejtim të fitimit të statusit të nëpunësit civil, si dhe në ofrimin e trajnimeve të vazhdueshëm për administratën publike në nivel vendor. Ndërkohë që ASPA ofron trajnime institucionale për punonjësit e NJVV-ve, pjesa më të madhe e trajnimeve ofrohen nga donatorët, sipas fushës së veprimtarisë së NJVV-ve.

AMVV, në ushtrim të mandatatit të saj, është e angazhuar në koordinimin e proceseve të hartimit të moduleve dhe dhënjes së trajnimeve për NJVV-të, por kjo përpjekje është akoma për t'u konsoliduar. AMVV në bashkëpunim me ASPA dhe shoqatat e NJVV-ve, dhe me mbështetjen e projektit BtF-Helvetas, zhvilloi një Kornizë Bashkëpunimi me partnerët e angazhuar në dhënjen e trajnimeve për NJVV-të, si dhe hartoi Matricën e Zbatimit të kësaj kornize, e cila e miratua edhe nga "Grupi Ndërinstitucional i Punë për Akademinë për NJVV-të", me qëllim rritjen e efektivitetit dhe të cilësisë së moduleve dhe trajnimeve për NJVV-të.

Koordinimi nga ana e AMVV e trajnimeve bëhet edhe më i domosdoshëm duke patur parasysh numrin dhe larminë e ofruesve të trajnimeve për NJVV-të, si dhe numrin dhe kategoritë e punonjësve të NJVV-ve. Të gjithë aktorët e përfshirë në rritjen e kapaciteteve për NQV-të kanë ofruar trajnime për kategori të ndryshme të punonjësve dhe të zgjedhuv të NJVV-ve, numri i

të cilëve ka variuar nga rreth **21,442 në 2015,<sup>1</sup> rreth 32,000 në 2021,<sup>2</sup> 37,518 në 2022,<sup>3</sup> dhe rreth 39,000 në 2023.<sup>4</sup>**

Të dhënat e vitit 2015 prezantojnë një numër total prej rreth 23,134 të zgjedhur dhe punonjës në NJVV-të, duke përfshirë 1619 këshilltarë bashkiakë, 61 kryetarë bashkie dhe 12 kryetarë të këshillave të qarqeve. Numri prej 21,442 punonjësish të NJVV-ve të transferuar në bashkië e reja, në 2015, përbënte 0.77 % e popullsisë dhe 2.1 % të fuqisë punëtore në nivel kombëtar. Nga këto 12,903 punonjës ishin bashkitë (60%), dhe 7,394 nga komunat (34.5%), dhe 1,145 (5.3%) ishin në Këshillat e Qarqeve, dhe në total 7,807 ishin punonjës administrativë (pa përfshirë gjendjen civile, policinë vendore, inspektoriatin e ndërtimor, QKR) ose 36.4%, dhe 5,981 ishin nëpunës civil (NC) ose 28%.<sup>5</sup>

Në vitin 2022, numri gjithsej i punonjësve të 61 bashkive ka qenë 37,518. Në 2022 kanë qenë 5,472 punonjës me status të nëpunësit civil në administratën vendore ose 43.2% të numrit të përgjithshëm të administratës vendore. Numri i nëpunësve civilë në NJVV në 2022 është më i lartë krahasuar me vitin 2021 (4,076) dhe me 2020 (4,625).<sup>6</sup>

ASPAs gjatë vitit 2022 ka trajnuar 5,397 individë dhe ka patur një ndjekje prej 20,780 pjesëmarrësish në trajnime, nga të cilët 4,737 (23%) nga NJVV. Rreth 1,195 individë përfunduan trajnimin e detyrueshëm për nëpunësin civil në periudhën e provës “Prezantimi me Administratën Publike”, ndërsa 3,755 persona u trajnuan në fushën e integritimit Evropian. 2,692 punonjës vendor kanë ndjekur programin e trajnimit të afruar nga ASPA bazuar në raportimin e Drejtorive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në NJVV, ndërsa 2,168 punonjës vendor janë trajnuar nga ofrues të tjerë trajnimesh. Mbi legjislacionin e nëpunësit civil janë trajnuar 751 punonjës vendor. Në vitin 2022, bashkitë kanë shpenzuar mesatarisht rreth 0,0275% të buxhetit vendor për të mbështetur trajnime të stafit të bashkive.

Sipas të dhënave të ASPA, nga NJVV-të, në vitin 2022 janë trajnuar 4,737 pjesëmarrës, apo 1.598 individë, nga të cilat 4,569 pjesëmarrës me statusin e nëpunësit civil. Gjatë vitit 2022, u trajnuan 32 pjesëmarrës nga Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues, 200 pjesëmarrës nga niveli i mesëm i menaxhimit, 527 nga niveli i ulët i menaxhimit, 3,810 pjesëmarrës nga niveli ekzekutiv. Nga pjesëmarrësit e trajnuar në vitin 2022, 2,125 ishin nga bashki të mëdha dhe 2,409 nga bashki të vogla, ndërkohë që në vitin 2022 u trajnuan 1,748 pjesëmarrës nga bashki të afërta me Tiranën dhe 2.786 pjesëmarrës nga bashki të largëta me Tiranën.<sup>7</sup>

<sup>1</sup> Konferenca Kombëtare Reformat në qeverisjen vendore dhe administratën publike, 03 Maj 2016, projekt i financuar nga Qeveria Svicere dhe i zbatuar nga Këshillit i Europës.

<sup>2</sup> Raporti i Monitorimit të Strategjisë së Decentralizimit dhe NJQV - 2015-2022, Korrik 2021.

<sup>3</sup> Raporti i Vlerësimit të Ecurisë së Bashkive në Procesin e Integritimit Evropian, 2022; projektit “Bashkitë për në Evropë”.

<sup>4</sup> Bazuar në prezantimin e AMVV në kuadër të iniciativës së Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor për reformimin e sektorit të qeverisjes vendore (Mars 2024).

<sup>5</sup> Konferenca Kombëtare Reformat në qeverisjen vendore dhe administratën publike, 03 Maj 2016, projekt i financuar nga Qeveria Svicere dhe i zbatuar nga Këshillit i Europës.

<sup>6</sup> Raporti i Vlerësimit të Ecurisë së Bashkive në Procesin e Integritimit Evropian për vitin 2022, në kuadrin e projektit “Bashkitë për në Evropë”.

<sup>7</sup> Dokumente politike (Paper) “Një Strukturë e Dedikuar Trajnimi për Qeverisjen Vendore në Shqipëri -

Ndërkohë, HRMIS (Sistemi Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore) është databaza shtetërore që mban dosjet digjitale të punonjësve të administratës publike, përdorimi i kësaj databaze dhe përditësimi i të dhënëve nga NJVV-të, mbetet sfidë. Aktualisht më pak bashki e kanë patur sistemin HRMIS funksional në vitin 2022, vetëm në 33 bashki, ose 7% më pak bashki se në vitin 2021.<sup>8</sup> Të dhënat e trajnimeve të punonjësve të NJVV-ve, përfshirë ato të nëpunësve civilë, nuk përfshihen rregullisht në HRMIS.

## **2. SYNIMI DHE TARGET I USHTRIMIT**

Qëllimi i këtij raporti është identifikimi dhe hartëzimi i moduleve të trajnimit dhe i strukturave që ofrojnë aktivitete trajnuese për rritjen e kapaciteteve për NJVV-të për të udhëzuar llojet e trajnimeve që do të japë Akademia për NJVV-të dhe bashkërendimin e punëve mes Akademisë, aktorëve qeveritarë dhe jo-qeveritar në ofrimin e trajnimeve cilësore dhe sipas nevojave për të mundësuar rritje të qëndrueshme të kapaciteteve të burimeve njerëzore të NJVV-ve.

Objektivi kryesor i këtij raporti është hartëzimi i moduleve të trajnimit dhe i strukturave që kanë ofruar trajnime për NJVV-të përgjatë periudhës 2019-2023, dhe planifikimet e trajnimeve për NJVV-të për vitin 2024.

Në procesin e hartëzimit u përfshinë aktorë qeveritarë kombëtar, si ASPA, NJVV, si dhe aktorë jo-qeveritarë si shoqatat e NJVV-ve (SHAV, SHKQSH), dhe organizata dhe programe të mbështetura nga donatorë, të cilët ofrojnë trajnime për rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe të zgjedhurve vendorë të NJVV-ve.

Procesi i hartëzimit identifikoi edhe bashkëpunime mes aktorëve dhe strukturave trajnuese, veçanërisht mes ASPA, shoqatave të qarqeve dhe donatorëve, dhe perfituesve të bashkive, trajnimit, kryesisht bashkive. Kjo tregon se ka nevojë që në të ardhmen të konsiderohet një koordinim më i mirë midis të gjithë aktorëve. Koordinimi dhe shkëmbimi i përvojave mes aktorëve të ndryshëm në fushën e administratës publike lokale është i rëndësishëm për pasjen e një sistemi efektiv dhe eficient.

## **3. METODOLOGJIA**

Metodologjia përfshin një kombinim të (i) punës kërkimore, (ii) hartimit të pyetësorëve të strukturuar për ASPA, strukturat tjera trajnuese si dhe donatorët, dhe (iii) analizës së të dhënave. Pyetësorët synonin mbledhjen e të dhënave për modulet dhe trajnimet e dhëna gjatë periudhës 2019-2023 dhe programet e trajnimit të planifikuar për vitin 2024, duke theksuar fokusin tematik dhe grupet e synuara.

---

Sfondi, Nevojat dhe Opsionet”, nga Dr. Brian Cawley, Qershor 2023; Në kuadër të projektit “Bashki të Forta”-Helvetas.

<sup>8</sup> idem

ASPA ishte një nga burimet kryesore të të dhënave për modulet dhe trajnimet e dhëna për NJVV-të. Një informacion i rëndësishëm, në ndihmë të këtij hartëzimi, u mor edhe nga “Raportit të Ecurisë së Bashkive në Procesin e Integritimit Evropian” 2022,<sup>9</sup> ku paraqitet një përmbledhje e trajnimeve të marra nga bashkitë të parë nga këndvështrimi i integritimit evropian në nivel vendor dhe legjisllacionit që zbatohet (70% e legjisllacionit të BE-së zbatohet në nivel vendor).

Instrumentet e përdorura për këtë analizë:

Punë kërkimore: Puna kërkimore filloi me identifikimin e aktorëve kryesorë të sistemit dhe kapilarizimin sa më shumë të të gjithë aktorëve dhe tipologjive të trajnimeve të dhëna për pushtetin vendor. Ky proces fillimisht u fokusua me ASPA - shqyrtimi i kujdesshëm i trajnimeve të ofruara nga ASPA gjatë periudhës 2019-2023 dhe nga donatorët/organizatat dhe përfituesit e këtyre trajnimeve. Puna kërkimore u bazua në të dhënat dhe listën e trajnimeve, marrë kryesisht nga raportet e ASPA. ASPA përditëson rregullisht nevojat vjetore të trajnimit për NJVV-të dhe ka bashkëpunim të ngushtë me donatorët, duke mundësuar koordinimi i programeve të trajnimit dhe shmangie të mbivendosjeve të trajnimeve mes ASPA dhe partnerëve të saj.

Nga ASPA u morën informacionet si më poshtë, të cilat përbënë shtyllën kryesore të informacionit, i cili u pasurua me inputin e aktorëve të tjerë të sistemit:

- Listimin e moduleve të trajnimeve për periudhën 2019-2023;
- Përcaktimin e target grupit për secilin modul (status nëpunësi civil, kontratë pune, tjetër apo kategori të miksuara në të njëjtin trajnim);
- Përcaktimin e partnerit mbështetës për zhvillimin e këtyre trajnimeve;
- Kohëzgjatja e trajnimeve;
- Vitet në të cilat janë dhënë këto module;
- Kalendarin e trajnimeve të planifikuara për vitin 2024 me burime të brendshme të institucionit, (inhouse) realizimi i të cilave kryhet nga Sektori i Rritjes së Kapaciteteve në Drejtorinë e Trajnimit dhe Zhvillimit në bashkëpunim me nëpunës me eksperiencë dhe trajnime të vazhdueshme në fushat ku ushtrojnë detyrat funksionale;
- Vlerësimin e Nevojave për Trajnim (VNT) për vitin 2024.

Pyetësorët për aktorët qeveritare e dhe donatorët: Identifikimi i aktorëve kryesorë të përfshirë në rritjen e kapaciteteve të NJVV-ve. Informacioni i mbledhur ofroi më shumë të dhëna, duke mundësuar hartimin e një pasqyre të plotë të përpjekjeve për fotografimin narrativ të ofrimit të trajnimeve për pushtetin vendor dhe planifikimit për trajnimet në vitin 2024.

Pyetësorët për bashkitë dhe donatorët u dërguan nga AMVV, ndërkohë që pyetësorët për institucionet dhe agjencitë qeveritare u dërguan nga ASPA, dhe konkretisht: 119 institucione

---

<sup>9</sup> Projektit ‘Bashkitë për në Evropë’ financuar nga BE

varësie, 18 ministri, 27 institucione të pavarura, 27 donatorë, 2 Shoqata të NJVV dhe 61 bashki. Në total u mblodhën 35 përgjigje nga bashkitë. Koordinimi për komunikimin me 61 bashkitë u asistua nga Njësitë e Integritimit Evropian.

Analiza e të dhënave: Të dhënat që u mblodhën u hodhën në një format të përpunueshëm në databaza exceli për t'u agreguar dhe analizuar për të gjithë aktorët e përfshirë.

Takimet me aktorët e sistemit: U organizuan takime me aktorët e ndryshëm të sistemit për të marrë një kuptim më të qartë dhe të gjerë të fushave të veprimtarisë në lidhje me trajnimet për NJVV-të, si dhe problematikat e hasura, duke dhënë mundësinë e identifikimit të rekomandime për punën e Akademisë dhe koordinimin e trajnimeve mes të gjithë aktorëve të sistemit dhe ofruesve të trajnimeve. Për të mundësuar përpunimin e të dhënave, të gjitha institucioneve, agjencive dhe projekteve të mbështetura nga donatorët, iu kërkua që të përcillnin informacion sipas një tabele të unifikuar për periudhën 2019-2023 dhe vitin 2024.

Informacioni që u kërkua nga institucionet, përmes pyetësorëve të strukturuar, kishte të bënte me modulet e trajnimeve të hartuara dhe trajnimeve të dhënave për periudhën 2019-2023, përfshirë përcaktimin e target grupit për secilin modul (status nëpunësi civil, kontratë pune, tjetër apo kategori të miksuara në të njëjtin trajnim); përcaktimin e partnerit mbështetës për zhvillimin e këtyre trajnimeve; kohëzgjatjen e trajnimeve; vitet në të cilat janë dhënë këto module.

Në Aneksin 2 gjeni listën e institucioneve të cilave ju dërgua pyetësori dhe në Aneksin 3 pyetësorin e plotësuar nga institucionet.

#### **4. PROCESI I KONSULTIMIT**

Me qëllim marrjen e një informacioni sa më të plotë dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve të sistemit, për të siguruar mbulimin e sa më të gjerë të hartëzimit dhe përfshirjen e aktorëve të rëndësishëm, AMVV në koordinim me BtF organizoi një sërë takimesh koordinuese.

Në takimin me AMVV, u diskutua metodologjia, përmbajtja e pyetësore, grupet dhe mënyra e shpërndarjen e pyetësorëve të strukturuar, si dhe koordinimi me aktorët e përfshirë. Po ashtu, u vijua bashkëpunimi me ASPA për koordinimin e procesit dhe kontributin me të dhëna për raportin e hartëzimit. Me ASPA u diskutua në lidhje me organizimin e punës për mbledhjen e të dhënave, u diskutua për vlerësimin e nevojave të trajnimeve nga ASPA, raportimi për periudhën 2019-2023, kalendari i trajnimeve të planifikuara për 2024, si dhe përdorimi i databazës së donatorëve/partnerëve të tjerë dhe listës së drejtuesve të njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore të bashkive dhe agjencive qeveritare, për të kapilarizuar marrjen e informacionit.

Komunikimi me Drejtorinë e Trajnimeve në Bashkinë Tiranë dhe takimi me Njësitë e Integritimit Evropian të disa bashkive ishin të rëndësishme për të siguruar marrjen e informacionit në

lidhje me nevojat specifike të trajnimeve dhe përgatitjen për integrimin evropiane. Komunikimi me burimet njerëzore të disa bashkive adresoi edhe vështirësinë e problematikat në sigurimin e informacionit për shkak të ndryshimit të stafeve dhe mosdisponimit të të dhënave të trajnimeve të përfituara nga bashkitë.

Në Aneksin 1 gjeni tabelën përmbledhëse të takimeve të zhvilluara.

## **5. VËSHTRIM MBI AKTORËT E SISTEMIT DHE OFRIMIN E TRAJNIMEVE PËR QEVERISJEN VENDORE**

Kjo pjesë e raportit jep një përshkrim të shkurtër të roleve të ASPA, agjencive të tjera qeveritare, shoqatave të NJVV, programeve me mbështetje të donatorëve (projekteve të assistences & OJF-ve), institucioneve shtetërore të pavaruara për trajnimet për NJVV-ve.

ASPA është institucion publik qendror, me autonomi administrative dhe akademike, që ka për qëllim formimin e nëpunësve të pushtetit qendror, pushtetit vendor, si dhe institucioneve të pavaruara. ASPA ushtron veprimtarinë e saj prej vitit 2000<sup>10</sup>, fillimisht e organizuar si Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) dhe prej vitit 2013, si Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Organizimi dhe funksionimi i ASPA rregullohet me Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138 datë 12/03/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë”. ASPA ofron shërbime të ndryshme në kuadër të programit të trajnimit në klasë, programit të trajnimit për trajnerë, programit të intershipit, programit e-learning, etj. Çdo vit ASPA trajnon rreth 5000 zyrtarë publikë, mbështetur në më shumë se 100 module didaktike trajnimi. ASPA bashkëpunon me trajnerë që vijnë nga bota akademike, administrata publike, si dhe ekspertiza lokale e fushave të ndryshme.

Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV), e themeluar në 2010, ka për qëllim zbatimin e parimit Kushtetutës për decentralizimin dhe forcimin e autonomisë vendore, zbatimin e parimeve të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, si dhe rritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe kualifikimeve të administratës dhe të zgjedhurve vendorë, shkëmbimeve të eksperiencave më të mira mes NJVV-ve.<sup>11</sup>

Për të pasuruar më shumë këtë analizë, u zhvillua edhe një kërkim mbi aktivitetet e rritjes së kapaciteteve për NJVV-të edhe nga institucione të tjera. Në këtë analizë u përfshinë:

- (i) Akademia e Sigurisë,<sup>12</sup> për të cilën nuk u administruar informacion zyrtar në lidhje me trajnimet për NJVV-të, por ndërkohë kjo akademi trajnon policinë bashkiake dhe personelin e reparteve bashkiake të zjarrëfikësve.

---

<sup>10</sup> Strategjia ASPA 2023-2030

<sup>11</sup> <https://www.shav.al/sq/>

<sup>12</sup> <https://asp.gov.al/?cat=34>

- (ii) INSTAT (Support for Strong Albanian Local Statistics -SALSAT),<sup>13</sup> përmes projektit “Statistika të Forta Vendore Shqiptare”, SALSTAT, si pjesë edhe e projektit “Bashki të Forta” të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ndihmon ndërtimin e një sistemin statistikor vendor në Shqipëri dhe ngritjen e kapaciteteve të administratës së bashkëpunimit lidhje me statistikat nivel rajonal dhe vendor.
- (iii) Qendra “Shkolla e Drejtoreve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar” (CSL),<sup>14</sup> që ka për qëllim mbështetjen e zhvillimit profesional të drejtorëve/nëndrejtorëve në detyrë dhe kandidatëve për drejtues të institucioneve të arsimit parauniversitar publik dhe privat, dhe i shërben të gjithë grupeve të mësuesve, drejtorëve dhe zv/drejtorëve në shkollat e arsimit parauniversitar. Modulet e trajnimit fokusojnë aspekte të menaxhimit të shkollës.
- (iv) Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore (QTATD),<sup>15</sup> në varësi të Ministrisë së Financave, ofron formimin profesional të administratës tatimore në nivel qendror dhe vendor, kryesisht në lidhje politikën fiskale dhe menaxhimin e taksave.
- (v) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,<sup>16</sup> që ka përfshirë në planet e punës së institucionit aktivitete për rritjen e kapaciteteve të administratës publike mbi të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit publik dhe të dhënat e hapura, zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe trajnime mbi rolin dhe detyrat e Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, forcimin e kapaciteteve të administratës publike për aksesin në informacion dhe transparencën proaktive (përfshirë NJVV), si dhe bashkëpunime me institucionet përgjegjëse (ILDPKKI dhe ASPA);
- (vi) Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,<sup>17</sup> i cili parashikon në planin strategjik të punës zhvillimin e aktiviteteve trajnuese, duke përfshirë edhe NJVV.
- (vii) Zyra e Avokatit të Popullit,<sup>18</sup> ka eksperiencë në ofrimin e trajnimeve për NJVV-të, edhe pse aktualisht nuk identifikohen plane për zhvillimin e këtyre trajnimeve për 2024.

Projekti i Këshilit të Evropës “Mbështetja e Reformës së Administratës Publike në Nivel Vendor në Shqipëri” do të mbështesë në zhvillimin e kapaciteteve institucionale për trajnimin e administratës publike vendore duke zhvilluar produktet si më poshtë:

- Upgrade/Përmirësim i instrumentit/modulit të Vlerësimit të Nevojave për Trajnim të ASPA. Moduli do të përditësohet për të siguruar një mbledhje më të strukturuar të nevojave për trajnim, dhe duke lehtësuar procesin e analizimit dhe përpunimit të të dhënave. Moduli do të përmbajë një strukturë, mbi të cilën mund të ngarkohen

<sup>13</sup> <https://www.instat.gov.al/>

<sup>14</sup> <https://csl.edu.al/>

<sup>15</sup> <http://www.qtatd.gov.al/>

<sup>16</sup> <https://www.idp.al/>

<sup>17</sup> <https://www.kmd.al/>

<sup>18</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/>

pyetësorë që arrijnë automatikisht grupet e synuara. Struktura mund të suportojë pyetësorë të cilët do të mund të ndryshohen/përshtaten sipas qëllimeve specifike për të evidentuar nevojat për një tematikë të caktuar.

- Në të njëjtën kohë projekti do të mbështesë një extension të platformës LMS (Learning Management System) për të mundësuar një akses më të gjerë dhe për një periudhë më të gjatë kohore të nëpunësve publikë në këtë platformë. Kjo mundëson aksesin e nëpunësit në llogarinë e vet, gjatë të gjithë ciklit të të nxënies, që nga evidentimi i nevojës për trajnim, tek marrja e trajnimit dhe deri në një moment të dytë të vlerësimit të impaktit të trajnimit.
- Momentalisht po punohet me ASPA për të rekomanduar një strukturim dhe një përmirësim të procesit të analizimit të TNA dhe për drejtuar/fasilituar transformimin e TNA nga metoda tradicionale në atë digjitale (përmes modulit TNA).
- Në kuadër të projektit, po punohet për zhvillimin e një kuadri të përgjithshëm kompetencash për nivelin vendor duke synuar në një kategorizim të kompetencave bazë (core) dhe atyre funksionale apo me specifike, çka do të mund të strukturojë akomë më tej procesin e Vlerësimit të nevojave për Trajnim duke e bazuar atë në kompetenca. Kështu nevojat për trajnim të nëpunësve do të jenë të mundura të përzgjidhen vetëm në bazë të kompetencave që pozicioni (apo niveli) i punës ka të parashikuara.

Të gjithë produktet e përmendura më sipër parashikohen të përfundojnë gjatë vitit 2024 dhe mund të jenë në dispozicion të Akademisë në momentin e krijimit të saj.

Institucionet publike dhe projektet donatore të ndryshme, që operojnë në fushën e rritjes së kapaciteteve të NJVV-ve, bashkëpunojnë drejtëpërdrejtë me NJVV-të për dhënjen e trajnimeve, sipas planeve të tyre të trajnimit, si dhe në disa raste i ofrojnë trajnimet për NJVV-të në bashkëpunimit me ASPA.

### ***6.1 Sfondi i përgjithshëm i të gjithë strukturës ofruese të trajnimeve për NJVV-të***

Pyetësorët e plotësuar nga ASPA, projektet donatore, shoqatat e NJVV-ve, institucionet publike, dhe Bashkia Tiranë, u përpunuar duke ndjekur hapat më poshtë:

- Kategorizimi i moduleve të trajnimit, për efekt të hartëzimit, të bërë edhe në referencë të Ligjit nr. 139/2015 dhe të moduleve të ASPA, dhe konkretisht:

#### **TRAJNIME SEKTORIALE - Fusha Zhvillimore dhe të Ofrimit të Shërbimeve Publike**

1. Infrastruktura dhe shërbimet publike
2. Shërbimet sociale
3. Kultura, sporti, dhe shërbimet argëtuese
4. Mbrojtja e mjedisit

5. Bujqësia, zhvillimi rural, pyjet dhe kullotat publike, natyra, dhe biodiversiteti
6. Zhvillimi ekonomik vendor
7. Siguria publike
8. Funksionet dhe kompetencat e deleguara

#### **TRAJNIME HORIZONTAL – Aspekte të Qeverisjes**

9. Menaxhimi financiar, Buxheti, Auditimi
10. Fusha ligjore, Etika, Integriteti, Barazia gjinore, Antidiskriminimi, Të drejtat e Njeriut, Përfshirja në qeverisjen vendore.
11. Lidërshipi dhe Menaxhimi (përfshirë të zgjedhurit)
12. Proceset e punës (prokurimi, arkivat, BNJ, statistikat, shkrimi i projekteve, etj)
13. BE
14. e-Gov

### **6.2 Modulet dhe trajnimet e identifikuara sipas kategorive horizontale dhe sektoriale**

Në këtë pjesë të raportit analizohet trajnimet për rritjen e kapaciteteve të NJVV-ve nga ASPA, agjenci të tjera trajnuese dhe donatorë, në fushat sektoriale dhe horizontale, për periudhën 2019-2023. Numri, emërtesa, kategorizimi i moduleve/temave të trajnimit janë bazuar në të dhënat e grumbulluara nga ato të anketuar që kanë dërguar pyetësorë të plotësuar.

Në periudhën 2019-2023 ASPA dhe ofruesit e tjerë të trajnimeve, përfshirë programet donatore, kanë adresuar në aktivitetet e tyre trajnuese 4 fusha sektoriale të NJVV-ve nga 7 fusha në total, dhe 5 fusha horizontale nga 6 në total, të përcaktuara për efekt të këtij hartëzimi. Disa fusha janë mbuluar me trajnime njëkohësisht si nga ASPA edhe nga programe donatore, gjë e cila identifikon nevojën për një koordinim më të mirë mes ASPA dhe aktorëve të tjerë të trajnimeve për NJVV-të.

Për periudhën 2019-2023 janë trajnuar punonjës dhe të zgjedhur të NJVV-ve, përmes **234** moduleve/temave të trajnimit, nga të cilat **49** (21%) module për tema sektoriale dhe **185** (79%) module për tema horizontale.

Nga 49 modulet/temat sektoriale, nga ofruesit e trajnimeve janë fokusuar fushat, si:

- **12** module/tema në fushën e **infrastrukturën** dhe **shërbimet publike**, kryesisht: 5 module nga SHAV për infrastrukturën dhe shërbimet publike, 5 module nga Bashki të Forta-Helvetas për arsimin parashkollor, 3 module nga Bashki të Forta-Helvetas për menaxhimin e integruar të mbetjeve në bashkitë partnere (*planifikimit, monitorimi, raportimit, konsultimi i planit; financimi, kostimi dhe politika fiskale për shërbimin; skema rajonale e depozitimi të mbetjeve dhe bashkëpunimi ndërbashkiak*).
- **26** module/tema në fushën e **shërbimet sociale**, kryesisht: 1 module nga SHAV, 4 modul trajnimi nga Terre des hommes, 19 module trajnimi nga UNDP, 1 modul trajnimi nga

UNWOMEN, 1 modul trajnimi nga Instituti i Kërkimeve Urbane dhe 2 nga Komisioneri per Antidiskriminimin.

- **4** module trajnimi nga FLAG, për **mbrojtjen e mjedisit**, menaxhimin e integruar të **mbetjeve**.
- **7** module trajnimi për **zhvillimi ekonomik vendor**, kryesisht: 3 module nga ADRIONËT në bashkëpunim me SHAV, 1 modul nga UNWOMEN, 2 modul nga OSBE, 1 module nga NALED dhe SHAV.

Nga 185 modulet/temat horizontale, nga ofruesit e trajnimeve janë fokusuar fushat, si:

- **73** module/tema në fushën **financiare**, kryesisht: 15 module trajnimi nga ASPA, 23 nga Ministria e Financave, 21 modul nga “Financat Lokale”, 6 module nga Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, 4 module nga UNWOMEN, 1 modul nga Instituti i Kërkimeve Urbane, 2 module trajnimi nga SHAV.
- **32** module/tema në fushën **ligjore** (*Etika, Integriteti, Gjinore, Antidiskriminimi, Te drejtate Njeriut, Përfshirja në qeverisjen vendore*), kryesisht: 15 module nga ASPA, 3 module nga Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, 3 module nga UNDP, 1 modul nga GIZ, 1 modul nga URI, 3 modul nga EU/SHAV dhe ADRIONËT, 1 1 modul nga Austrian Development Cooperation and UNWomen.
- **10** module/tema në fushën **e lidershipit dhe menaxhimit**, kryesisht: 6 module nga Bashki të Forta-Helvetas për këshilltarët bashkiakë, 3 module nga ASPA, 1 module nga Këshilli i Evropës.
- **56** module trajnime për **proceset të punës**, kryesisht: 45 module nga ASPA, 3 module trajnimi nga SHAV, 1 modul trajnimi SALSTAT, 1 module trajnimi nga IDM, 1 modul trajnimi nga GIZ, 4 module trajnimi nga IOM, 1 modul trajnimi nga Partneret per Ndryshim, për **proceset të punës**;
- **14** module trajnimi për **BE**, kryesisht: 2 module nga ASPA, 8 module nga B4E dhe ASPA, 2 module trajnimi nga GIZ, 1 trajnimi nga Instituti i Kërkimeve Urbane, 1 modul trajnimi nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.


Trajnimi i lidershipit të bashkive, kryesisht i këshilltarëve bashkiakë, përfshirë: trajnimin hyrës për këshilltarët, rregullorja dhe funksionimi i këshillit, konsultimet e këshillit me publikun, ankesat, kërkesat dhe peticionet drejtuar këshillit, këshilli digjital dhe komunikimi me median, sekretariati i këshillit, kënaqësi që një risi në trajnimet për këshilltarëve bashkiakë dhe stafin e tyre, të ofruara gjatë 2019-2023, dhe u mbështetën nga projekti Bashki të Forta-Helvetas, në bashkëpunim me shoqatat e bashkive, AMVV dhe ASPA.

Modulet e trajnimit në lidhje me shërbimin e arsimit parashkollot të decentralizuar në 2015, ishin gjithashtu risi, dhe përfshinin 5 module trajnimi si: planifikimi i shërbimit; proceset e punës; menaxhimi i shërbimit dhe i aseteve; taksa e përkohshme; shërbimi në rast emergjence shëndetësore-Covid.


Integrimi Evropian është targetuar gjerësisht nëpërmjet projektit BpE me 3 module kryesore për (1) Komunikimin, Shkrimin Efektiv, Menaxhimin e Strukturave të Integritit Evropian, (2) Integrimi Evropian në Nivel Vendor me nënmodule për Procesin e Integritit, Integrimi në

Nivel Vendor dhe Roli i Bashkive, Zbatimi i Acquis në nivel vendor sipas kapitujve, politikat e kohezionit (3) Mekanizmat Financiare të BE-së duke përfshirë informacion të përditësuar në lidhje me fondet e BE-së dhe thirrjet sipas programeve, cikli i Shkrimit të Projekt Propozimeve në praktikë lidhur me thirrje të hapura, Procedurat e Prokurimit sipas PRAG dhe Menaxhimi i projekteve të financuara nga BE, raportimi dhe auditimi.


**Grafik 1.** Modulet e trajnimeve sipas fushave sektoriale vs. horizontale për periudhën 2019-2023.




**Grafik 2.** Modulet e trajnimeve sipas fushave dhe ofruesve për periudhën 2019-2023



**Grafik 3.** Trajnimeve sipas ofruesve për periudhën 2019-2023



**Grafik 4.** Numri i moduleve sektoriale të trajnimit sipas funksioneve të bashkive



### **6.3 Modulet dhe trajnimet e identifikuar sipas grupeve të synuara: të zgjedhur dhe administratë publike (nëpunës civil dhe Kod Pune)**

Për periudhën 2019-2023 SHAV ka ofruar trajnime si për nëpunësit civilë, edhe për ata që nuk e kanë këtë status. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe Bashkia Tiranë kanë ofruar trajnime vetëm për nëpunësit civilë. Organizatat e tjera kanë pasur target grupe specifike, p.sh, Këshilli i Evropës që ka trajnuar kryetarët, nënkryetarët dhe stafet e ngushta drejtuese, UNDP ka trajnuar koordinatorët lokale të dhunës në familje si dhe anëtarët e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit, profesionistë të qendrave komunitare, punonjës dhe profesionistë të shërbimeve sociale në bashki, projekti “Bashki të Forta-Helvetas ka trajnuar këshilltarë bashkiakë dhe punonjës të bashkive, Insituti i Kërkimeve Urbane ka trajnuar anëtarët e Këshillit Konsultativ dhe stafin e tyre mbështetës, Qendra e Trajnimit të

Administratës Tatimore dhe Doganore ka trajnuar punonjës të administratës tatimore dhe doganore si dhe Akademia e Studimeve Politike që ka trajnuar të zgjedhurit dhe nëpunësit civilë (kryetarë, nënkryetarë, sekretarë të përgjithshëm, drejtorë të lartë). ASPA ka paur target grup të gjithë administratën, si ata me status nëpunësi civil, ashtu edhe ata me Kod Pune. Ndërsa më mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, ASPA ka ofruar trajnime edhe për të zgjedhurit.

Si konkluzion, një koordinim më i mirë i ASPA me programet donatorëve, në lidhje me trajnimet, do të sillte trajnime për të gjithë grupet synuara të NJVV-ve dhe një shpërndarje të mirë të trajnimeve në territor.

#### ***6.4 Modulet dhe trajnimet e identifikuar sipas grupeve kryesorë të ofruesve të trajnimeve.***

Në periudhën 2019-2023 agjencitë qeveritare, përfshirë ASPA, si dhe organizatat dhe projektet e mbështetura me fonde donotare,<sup>19</sup> kanë zhvilluar një seri trajnimesh për NJVV-të, duke përdorur 159 module, nga të cilat 50 për fusha sektoriale të NJVV-ve dhe 109 në fushat e qeverisjes

Konkretisht, ASPA ka ofruar trajnime, vetë apo në bashkëpunim me partnerë, me gjithësej **92** module trajnimi fushat e qeverisjes (jo sektoriale), nga të cilat **15** module trajnimi në fushën e menaxhimit financiar; **20** module trajnimi për fushën ligjore; **3** module trajnimi për lidërsip dhe menaxhim (përfshirë të zgjedhurit); **45** module trajnimi për procese të punës dhe **9** module trajnimi për BE.

Ndërkohë, nga institucionet, organizatat dhe projektet e mbështetura me fonde donotare janë ofruar trajnime për NJVV-të, me gjithësej **143** module trajnimi nga të cilat **49** module në fushat sektoriale dhe **94** module në fushat e qeverisjes. Më konkretisht, **13** module trajnimi për infrastrukturën dhe shërbimet publike; **20** module trajnimi për shërbimet sociale; **4** module trajnimi për mbrojtjen e mjedisit dhe mbetjet; **7** module trajnimi për zhvillim ekonomik vendor; **58** module trajnimi për fushën financiare; **12** module trajnimi për fushën ligjore; **8** module trajnimi për lidërsip dhe menaxhim (përfshirë të zgjedhurit); **11** module trajnimi për procese të punës dhe **5** module trajnimi për BE.

Ministria e Financave ka raportuar **37** module/tema trajnimi në dispozicin për NJVV-të, nga të cilat **23** janë përgatitur nga vetë Ministria, e nga këto **9** janë përgatitur në bashkëpunim me ASPA, dhe **14** janë përgatitur në bashkëpunim me donatorë (12 me "Financat

---

<sup>19</sup> Kryesisht: Këshilli i Evropës, Shoqata për Autonomi Vendore, Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, projekti "Bashki të Forta"- Helvetas, projekti "Financat Lokale", projekti "Bashkitë për në Evropë", Instituti i Kërkimeve Urbane, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Akademia e Studimeve Politike.

Lokale"/SECO dhe 2 me Bankën Botërore dhe SECO). Shih Shtojcën nr. 5 për listën e moduleve.


### **6.5 Modulet dhe trajnimet e planifikuara për vitin 2024**

Për vitin 2024, nga të dhënat e dërguara, donatorët<sup>20</sup> kanë planifikuar të zhvillojnë 36 module trajnimi për funksionet e bashkive. Konkretisht, 8 module për infrastrukturën dhe shërbimet publike; 11 module për shërbimet sociale, dhe 1 modul për zhvillimi ekonomik vendor. Gjithashtu janë planifikuar të zhvillohen 16 module trajnimi në fushat horizontale, dhe konkretisht, 8 module trajnimi për financat, 2 module për leadershipin, 6 module trajnimi për BE.

ASPA ka planifikuar të ofrojë 2 module trajnimi përfshirë 1 modul për legjislacionin për shërbimin civil dhe për administratën publike, ndërkohë Ministria e Financës planifikon të ofrojë 18 trajnime për financat, buxhetin etj.

Shih Shtojcën nr. 6 për listën e moduleve për 2024.

**Grafik 5.** Numri i moduleve të trajnimeve të planifikuara për vitin 2024



Këshilli i Evropës ka përcaktuar target grup të kalendarit trajnues 2024 njësitë e menaxhimit te burimeve njerëzore. Projektin “Bashki të Forta”/Helvetas ka planifikuar që trajnimet t’i ofrojë si për nëpunësit civilë ashtu edhe për të zgjedhurit vendor. SHAV ka planifikuar që trajnimet t’i ofrojë si për nëpunësit civilë, edhe për ata që nuk e kanë këtë status. UNDP ka

<sup>20</sup> Si më sipër.

planifikuar të ofrojnë trajnime për koordinatorët Lokale të Dhunës në Familje si dhe antarët e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në bashki, punonjes dhe profesioniste të shërbimeve sociale në bashki. ASPA do të ofrojë trajnimet për nëpunësit civilë, me përjashtim të modulit të trajnimit që do të zhvillojë në bashkëpunim me Bashkitë për në Evropë që do t'i ofrojë për punonjësit e NJVV-ve pavarësisht nëse e gëzojnë statusin e nëpunësit civilë apo jo. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ka planifikuar që t'i ofrojnë këto trajnime vetëm për nëpunësit civilë.

Si konkluzion, për vitin 2024 adresohen 3 fusha sektoriale, nga 7 në total dhe të treja këto fusha do të mbulohen nga donatorë, si dhe adresohen 4 fusha horizontale nga 6 në total, nga ASPA, Ministria e Financës dhe projekte donatore.

## **6. MODULET E INTEGRIMIT EVROPIAN**

Për periudhën 2019-2023, në lidhje me fushën e Integrimit Evropian, janë ofruar: 9 module trajnimi nga ASPA, 2 module trajnimi nga GIZ, 1 modul trajnimi nga BpE, 1 modul trajnimi nga Instituti i Kërkimeve Urbane, 1 modul trajnimi nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë për BE.

Trajnimet e NJVV-ve për çështje të Integrimit Evropian janë ofruar gjerësisht përmes bashkëpunimit të ASPA me projektin “Bashkitë për në Evropë”, të financuar nga Bashkimi Evropian. Modulet e Integrimit Evropian janë përmbledhur në nënmodule të cilat janë ofruar kryesisht për nëpunësit e Njësive të Integrimit Evropian, dhe që nga viti 2021 e në vijim janë shtrirë edhe tek punonjësit e tjerë të bashkive, në kuadrin e procesit të përafrimit të legjisllacionit.

Për vitin 2024 janë planifikuar që në fushën e BE të zhvillohen module trajnimi nga ASPA në bashkëpunim me projektin “Bashkitë për në Evropë”. Tematikat e nxjerra nga vlerësimi i nevojave për trajnim përfshin modulet e Prezantimit të Fondeve të Kohezionit (4 trajnime me Nënkytarët e Bashkive, Sekretarët e Përgjithshëm, stafet menaxheriale), Tematikat e Shkrimit të Projekteve (2 trajnime rajonale), PRAG (9 trajnime rajonale me zyrat e prokurimeve, juridike e ato që punojnë me projektet e BE-së ), Zbatimi i Projekteve, Auditi e Raportimi i Fondeve të BE-së (5 trajnime rajonale me zyrat e financës e stafet e zbatimit të projekteve të BE-së).

Me ngritjen e Forumit të Këshillave bashkiakë në 21 Shkurt 2024, BpE do të ndërmarrë një seri trajnimesh me këshillat e integrimit në të gjitha bashkitë që do të organizohen në nivel qarku.

## **7. MODULET E-LEARNING**

ASPА është burimi kryesor i marrjes së të dhënave përса i përket e-moduleve të hartuara për NJVV-të. Këto module janë hartuar nga ASPA në bashkëpunim me programe donatore, përmes platformës LMS që ASPA administron. ASP administron 6 e-module për NJVV-të, si në vijim:

1. "Qeveria Qendrore dhe Vetëqeverisja Vendore në Shqipëri", në kuadër të projektit "Asistenca Teknike e Këshillit Konsultativ i Qeverisë Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore", financuar nga Bashkimi Evropian, kurrikula u zhvillua nga Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) në bashkëpunim me ASPA.
2. "Trajnim përgatitor për këshilltarët bashkiak" zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit midis ASPA dhe projektit "Bashki të Forta"-Helvetas.
3. "Buxhetimi Gjinnor si instrument i menaxhimit të buxhetit publik në Pushtetin Lokal", zhvilluar në kuadër të projektit ALIVE, financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS) dhe implementuar nga CIES dhe ASPA.
4. "EU Legal History", zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit institucional midis "Ministrisë Federale Gjermane për çështjet ekonomike dhe të klimës" dhe ASPA, Western Balkans Digital, projekt "Digitalization of EU Training in the Public Administration on the Western Balkans".
5. "Trajnim për Njësitë e Integritit Evropian për çështjet e Integritit Europian të vendit", zhvilluar në kuadër të projektit të bashkëpunimit midis ASPA dhe projektit "Bashkitë për në Evropë".
6. "Trajnim Teknik për punonjësit e sistemit rregullator agro-ushqimor", zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit midis ASPA dhe "Projektit për Siurinë Ushqimore" (The Food Safety Project) financuar nga Bashkimi Evropian.
7. "Të drejtat e komunitetit LGBTI në Shqipëri", zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit midis ASPA, Aleancës LGBTI, ProLGBT dhe ambasadës së Holandës në Shqipëri.

## **8. KOSOT E TRAJNIMIT**

Të dhënat për kostot e trajnimit për person janë dhënë në pak raste nga të anketuarit, dhe kostot variojnë nga 3000, 7000, 10000, 15000, 20000 Lekë për të trajnuar, ndërkohë që kostot prej 5,000 dhe 10,000 Lekë janë më e cituar nga të anketuarit.

## **9. KONSTATIME DHE REKOMANDIME**

Hartëzimi i moduleve dhe trajnimeve për NJVV-të ishte një proces gjithëpërfshirës dhe për këtë arsye u përball me shumë vështirësi në lidhje më marrjen e përgjigjeve nga të gjithë të anketuarit, si dhe me mungesë të informacion të plotë, sipas kërkesave të pyetëorit.

Hartëzimi moduleve dhe trajnimeve për NJVV-të ndihmoi në identifikimin e disa problematikave me të cilat përballen ofruesit dhe përfituesit e trajnimeve për të zgjedhurit dhe punonjësit e NJVV-ve.

Në vijim jepen disa gjetje kyce të cilat AMVV, ASPA, shoqatat e NJVV-ve, projektet e donatorëve, si dhe Akademia, e cila planifikohet të ngrihet së shpejti, do të duhet ti adresojnë për të mundësuar një sistem të qendrueshëm, efektiv e të mirë koordinuar të monitoruar të trajnimeve për NJVV-të në mënyrë që të garantohen trajnime me cilësi, që i përgjigjen nevojave të NJVV-ve dhe sfidave të zhvillimit vendor dhe kombëtar, dhe që rrisin në mënyrë të qëndrueshme profesionalizmin e të zgjedhurve dhe punonjësve për një qeverisje të mirë dhe demokratike vendore.

- Nuk ka një agjenci që grumbullon dhe mirëmban, si dhe një databazë që dokumenton, të dhënat për trajnimet e NJVV-ve; nuk ka një raport kombëtar për trajnimet e marra nga NJVV-të.
- Ka mbivendosje të shumta mes trajnimeve të dhëna nga ofrues të ndryshëm, si dhe dhe mbivendosje të temave të trajnimit të dhëna nga projekte donatore të ndryshëm dhe agjenci të ndryshme qeveritare.
- Temat horizontale dominojnë (79%) trajnimet për NJVV-të, kundrejt temave sektoriale (21%), duke prezantuar kështu një hendek të madh në rritjen e kapaciteteve të punonjësve për aspektet zhvillimore dhe të ofrimit të shërbimeve bashkiake.
- Trajnimet për NJVV-të në fushën e menaxhimit financiar, buxhetimit, politikës fiskale, auditimit dhe menaxhimit të riskut, jepen nga disa ofrues shërbimesh, qeveritar dhe projekte donatore, duke krijuar mbivendosje
- Mungesa e një database për punonjësit e NJVV-ve të trajnuar nga ofrues të ndryshëm, krijon mundësinë që të njëjtët punonjës të marrin disa herë të njëjtin trajnim apo një trajnim të ngjashëm, nga ofrues të ndryshëm.
- Shumë prej trajnimeve kanë trajtuar tema të vecanta trajnimi, dhe jo module apo programe trajnimi të mirëfillta. Shumë prej këtyre temave janë përdorur në trajnime nga ofrues të ndryshëm, duke mos garantuar unifikimin dhe validimin e përmbajtjes për të njëjtën temë.
- NJVV-të nuk kanë një sistem pune dhe nuk kanë të dhëna të sistemuara dhe të mirëmbajtur për trajnimet e të zgjedhurve dhe punonjësve të NJVV-ve.
- Ka shumë mospërputhje midis të dhënave nga aktorët e ndryshëm dhe bashkitë (kjo është verifikuar edhe gjatë procesit të hartëzimit).
- Modulet e trajnimit për NJVV-të nuk janë të kodifikuara dhe të kategorizuara sipas fushave të kompetencës së NJVV-ve, dhe kjo shkakton shumë mbivendosje në hartimin e moduleve të trajnimit nga ofrues trajnimeshe për NJVV-të.

- Jo të gjithë modulet dhe trajnimet për NJVV-të janë të certifikuara nga ASPA, dhe një pjesë jepen jo në koordinim me ASPA.
- Modulet e trajnimit për NJVV-të nuk katalogohen dhe administrohen nga një agjenci qeveritare, ASPA administron vetëm modulet që përgatit vetë.
- Planet dhe kalendarët e trajnimit për NJVV-të nuk ndahen mes agjencive qeveritare dhe nuk administrohen nga një agjenci qeveritare apo shoqatë e NJVV-ve.
- Numri i e-moduleve për NJVV-të është shumë i vogël, ndërkohë që ASPA mundëson zhvillimin e e-moduleve.
- Nuk ka një vlerësim kombëtar periodik të nevojave për trajnim për NJVV-të që orientohen nga fushat e kompetencës së NJVV-ve dhe kuadri i kompetencave i zytarëve të NJVV-ve. Shpesh VNT tematike bëhet nga projektet donatore për të udhëzuar trajnimet e tyre në kuadër të zbatimit të projektit pëkatës
- Strukturat e Burimeve Njerëzore të Bashkive kanë pasur disa problematika për mbledhjen e të dhënave që duhen targetuar me ngritjen e Akademisë:
  - (i) Zyrat e menaxhimit të BNJ në disa bashki nuk kanë informacion të mirëmbajtur për trajnimet e dhëna të zgjidhurve dhe punonjësve të bashkisë, apo nuk gjejnë informacione të lëna nga drejtuesit e këtyre zyrave, të larguar më parë, dhe informacioni duhej marrë nga pyetësori të shpërndarë nga zyra tek drejtoritë e bashkisë. Në disa raste pyetësori i dërguar bashkisë, për efekt të këtij hartëzimi është plotësuar nga Njësitë e Integritimit në bashkëpunim me drejtorët e bashkive.
  - (ii) Në disa drejtori të bashkive ka stafe tërësisht të ndryshuara dhe kolegët e rinj të burimeve njerëzore që nuk disponojnë informacion nga kolegët e mëparshëm dhe nuk mund të marrin informacion për trajnimet nga viti 2019. Për këtë arsye nuk u morë të dhëna të plota;
  - (iii) Disa drejtori burimesh njerëzore nuk kanë një sistem të mbledhjes së të dhënave për trajnimet e stafeve.
- Metodologjia që përdoret nga projektet donatorët për hartimin e moduleve dhe dhënjen e trajnimeve nuk verifikohet nga ASPA, por ndërkohë ka raste të bashkëpunimit të projekteve donatore me ASPA, në lidhjen me modulet dhe trajnimeve për NJVV-të (rasti i BtF- Helvetas, UN projects, Ministria e Financave, GIZ, KiE, B4E/EU, Terre dde Hommë, URI).
- Modulet e trajnimeve që jepen për NJVV-të nuk depozitohen tek ASPA, dhe disa module jepen vetëm për disa bashki.

Disa nga sfidat që duhet të adresohen nga agjencitë qeveritare, NJVV-të dhe projektet donatore që punojnë për ngritjen e kapaciteteve në NJVV-të, janë:

- AMVV dhe Akademia duhet të kenë një komunikim dhe bashkëpunimi të rregullt me agjencitë qeveritare dhe institucionet e pavarura në lidhje me planet e tyre për trajnimet për NJVV-te.
- ASPA, AMVV dhe Akademia duhet të elemonojnë mbivendosje të dhënjes së trajnimeve dhe të moduleve e të temave të trajnimit të për NJVV-të.
- Eshtë e nevojshme që tema të njëjta trajnimi të dhëna njëkohësisht nga ASPA dhe nga ofrues të tjerë trajnimi për NJVV-të, të validohen e standartizohen nga ASPA apo Akademia, si dhe të bëhen pjesë e moduleve dhe programeve të trajnimit të miratuara.
- Shumë prej trajnimeve kanë trajtuar tema të vecanta trajnimi, dhe jo module apo programe trajnimi të mirëfillta. Shumë prej këtyre temave janë përdorur në trajnime nga ofrues të ndryshëm, duke mos garantuar unifikimin dhe validimin e përmbajtjes për të njëjtën temë,
- ASPA, AMVV dhe Akademia duhet të do duhet të bëjë një kategorizim të moduleve të trajnimit për të orientuar agjencitë qeveritare në dokumentimin e moduleve, të orientohen agjencitë përcaktohen saktë titujt e moduleve të trajnimit
- Duhet shtuar në një masë të madhe trajnimet për temat zhvillimore dhe të ofrimit të shërbimeve publike, për punonjësit e NJVV-ve.
- NJVV-të duhet të mbështeten në ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm për mbajtjen e të dhënave të konsoliduar dhe unifikuar për trajnimet e marra.
- ASPA do duhet të bëjë një kodifikimin dhe kategorizimin e moduleve të trajnimit për sipas fushave të kompetencës së NJVV-ve, për të orientuar agjencitë qeveritare dhe projekte donatore në përcaktimin e saktë dhe eliminimin e mbivendosjeve të titujve të moduleve të trajnimit.
- Duhet të mundësohet transparenca e trajnimeve për NJVV-të. AMVV dhe/apo Akademia të hartojë dhe publikojë një kalendar vjetor të trajnimeve për NJVV-të, si dhe të hartojë reportin vjetor kombëtar të trajnimeve për NJVV-të.
- Akademia duhet të zhvillojë një metodologji për vlerësimin e nevojave për trajnim (VNT) të NJVV-të, për të orientuar ofruesit e trajnimeve drejt nevoja të vlerësuara në mënyrë institucionale dhe sistemike. Platforma e VNT që po digjitalizohet në bashkëpunim me ASPA dhe Këshillin e Evropës, pjesë e <administrata.al>, do t'i shërbejë Akademisë për të vlerësuar nevojat për trajnim të NJVV-ve, në mënyrë të shpejtë dhe metodologjike.
- Eshtë e nevojshme zhvillimi dhe përditësimi i katalogut të trajnimeve që ofron Akademia duke përfshirë kurrikulat, modulet. target grupet, objektivat e kurrikulave përkatëse, kohezgjatja dhe shërbime të tjera.
